

RRJEDHA E PUNËS 2 – Sistemi dhe struktura

Veprimi 1: emëroni Zyrtarin e Mbrojtjes së klubit dhe komunikoni ekzistencën e tij/saj në klub.

Përshkrimi i profilit të Zyrtarit të Mbrojtjes (SO)

Cfare?

Një Zyrtar i Mbrojtjes (SO) brenda një klubi sportiv është një pikë kontakti lehtësisht e arritshme, ku sportistët, prindërit/familjet e tyre, trajnerët, anëtarët e bordit, stafi ose palë të tjera të interesuara mund të kërkojnë ndihmë, të shprehin dyshime ose të ankohen për dhunë ndërpersonale.

Perse?

Është e rëndësishme që në klubet sportive të ekzistojë një kulturë hapjeje, ku secili të ndihet i lirë të raportojë incidente. Vendosja e një Zyrtari të Mbrojtjes e bën të qartë për të gjithë se kujt mund t'i drejtohen për një raportim dhe siguron ndjekjen e qartë dhe në kohë të incidenteve.

Detyrat e një Zyrtari të Mbrojtjes

Zyrtari i Mbrojtjes dëgjon pyetjen ose rrëfimin e raportuesit dhe e drejton atë sipas nevojës ose këshillon mbi hapat e mundshëm të mëtejshëm, pa u futur në thelbin e çështjes ose pa vlerësuar vërtetësinë e saj. Për më tepër, Zyrtari i Mbrojtjes formulon këshilla mbi aktivitetet parandaluese brenda klubit sportiv dhe ndihmon anëtarët e bordit që t'i njohin këto iniciativa.

- **Pikë kontakti dhe pritja e parë**

Zyrtari i Mbrojtjes dëgjon rrëfimin e raportuesit, pa marrë rolin e përgjegjës për zgjidhjen e çështjes. Ai/ajo tregon mjaftueshëm empati, e bën raportuesin të ndiejë se po e dëgjojnë dhe nuk vë në dyshim rrëfimin. Çdokush në klub duhet të dijë se kush është Zyrtari i Mbrojtjes, si mund të kontaktohet ai/ajo dhe me çfarë pyetjesh ose mesazhesh mund t'i drejtohen.

- **Koordinimi i protokollit të ndjekjes dhe referimit**

Zyrtari i Mbrojtjes e merr çdo pyetje ose raport seriozisht. Ai/ajo nis protokollin e ndjekjes dhe siguron që procedura të ndiqet. Zyrtari krijon një pasqyrë të situatës, vlerëson seriozitetin dhe më pas i jep raportuesit informacion, këshilla ose referime.

Në rast dyshimesh ose treguesish për dhunë serioze ndërpersonale, nuk është detyra e Zyrtarit të Mbrojtjes të ofrojë ndihmë ose të kryejë vetë hetime, por të referojë tek ekspertët. Në rast emergjence, Zyrtari i Mbrojtjes referon menjëherë tek shërbimet mjekësore, policia, drejtësia etj.

▪ Parandalimi dhe mbështetja e qeverisjes së klubit

Në bashkëpunim me bordin e klubit, Zyrtari i Mbrojtjes do të sigurohet që ekzistenca dhe roli i tij/saj të jenë të njohura gjerësisht dhe të rrisë ndërgjegjësimin për kodet ekzistuese të sjelljes. Zyrtari i Mbrojtjes gjithashtu qëndron i informuar dhe u ofron informacion e këshilla anëtarëve të bordit të klubit në lidhje me dhunën ndërpersonale.

Përcaktimi i rolit: Çfarë nuk është një Zyrtar i Mbrojtjes

- një përgjegjës ndihme: nuk nis një proces ndihme dhe nuk ka sekret profesional
- një gjyqtar hetues: nuk duhet të ndjekë faktet
- një gazetar: nuk duhet të informojë askënd që është thjesht kurioz
- një anëtar bordi: nuk ka përgjegjësi vendimmarrëse, por vetëm një rol këshillues

Kerkesat kyce

Zyrtari i Mbrojtjes:

- preferohet të mos jetë kryetar ose (sa të jetë e mundur) të mos jetë anëtar bordi, ose të paktën të mos jetë një person dominues ku nuk është i mundur vlerësimi nga kolegët. Nëse emërohet një anëtar bordi, ai/ajo duhet të jetë në gjendje të veprojë në mënyrë të pavarur dhe të jetë transparent për konfliktet e mundshme të interesit;
- emërohet nga bordi i klubit përmes një mandati të qartë;
- është në gjendje të mbështetet në një konsultim të brendshëm (bordi i klubit) dhe të ekspertët në rast të një incidenti të madh;
- mund, me kërkesë, të paraqesë një ekstrakt nga regjistri penal (në varësi të legjislacionit në vendin tuaj);
- nuk kryen kërkime dhe nuk përcakton vetë të vërtetën;
- punon mbi bazën e protokollit të ndjekjes, procedurave, rregulloreve dhe statuteve të përcaktuara të klubit sportiv;
- është në gjendje të veprojë me diskrecion dhe të funksionojë në mënyrë të pavarur;
- mund të mbështetet në mbështetje dhe trajnim përmes një organizate eksperte

Çfarë duhet të dijë dhe të jetë në gjendje të bëjë një Zyrtar i Mbrojtjes?

Zyrtari i Mbrojtjes:

- ka njohuri bazë mbi dhunën ndërpersonale fizike, psikologjike dhe seksuale (veçanërisht në sport);
- është në gjendje të vlerësojë seriozitetin e një incidenti;
- ka njohuri të qarta mbi rolin e një Zyrtari të Mbrojtjes;
- është në gjendje të profillohet si Zyrtar i Mbrojtjes përpara të gjithëve në një klub;

- është në gjendje të trajtojë një incident bazuar në protokollin e ndjekjes të krijuar nga klubi sportiv;
- është në gjendje të zhvillojë dialog me të gjitha palët e përfshira;
- di ku të drejtohet për një ankesë ose ndihmë;
- është në gjendje të kryejë regjistrimin dhe krijimin e dosjes;
- është në gjendje të konsultohet me bordin e klubit dhe të bëjë sugjerime.

Komunikoni ekzistencën e Zyrtarit të Mbrojtjes në klub

Tekst shembull për Zyrtarin e Mbrojtjes

Emri im është (emri i Zyrtarit të Mbrojtjes). Unë jam Zyrtari i Mbrojtjes (SO) i (emri i klubit sportiv). Si sportist, prind/anëtar familjeje, trajner, vullnetar, staf apo çdo anëtar tjetër i klubit tonë, mund të më kontaktoni për çdo pyetje, shqetësim, dyshim ose ankesë në lidhje me çdo çështje që lidhet me dhunën dhe abuzimin.

- A po përballeni me një situatë të vështirë si dhunë psikologjike, fizike, seksuale, ngacmim, neglizhencë apo sjellje të tjera të padëshiruara?
- A vini re gjatë aktiviteteve tuaja sportive se po ndodhin veprime/sjellje të tilla të papranueshme?

Nëse përgjigjja juaj është po, mund të më kontaktoni me email në (adresa e emailit e caktuar e klubit perkates) ose të më telefononi në (numri i telefonit, I percaktuar si numer kontakti). Në (dita/datat te percaktuara nga Klubi ne njoftim), do të jem i pranishëm në klub dhe mund të flisni personalisht me mua.

Jam këtu për t'ju mbështetur, për të dëgjuar pyetjet ose shqetësimet tuaja, për të trajtuar situatën me plot diskrecion dhe për t'ju këshilluar mbi hapat e mundshëm të mëtejshëm ose referimin.

Emri dhe firma

Këshilla për komunikimin tuaj si Oficer i Mbrojtjes

Si Oficer i Mbrojtjes (SO), është e rëndësishme t'u bëheni të njohur njerëzve në klubin tuaj sportiv në mënyra të ndryshme dhe në momente të ndryshme. Mos supozoni se raportuesit do t'ju gjejnë përmes një liste emailësh ose vetëm sepse emri juaj është në faqen e internetit. Më poshtë do të gjeni disa këshilla për t'u siguruar që të jeni lehtësisht i/e aksesueshëm dhe i/e qasshëm/e për të gjithë.

- Prezantohuni personalisht tek anëtarët e klubit tuaj. Vizitoni seancat stërvitore. Në fillim të sezonit, organizoni një takim online ose fizik me trajnerët/udhëheqjen e ekipeve, dhe mund ta përsëritni këtë veprim gjatë vitit sportiv. Për shembull, mund të shpjegoni shkurt rolin tuaj në fund të një takimi me trajnerët, në një mbledhje bordi, në një takim informues për anëtarët, prindërit, etj. Një fytyrë e njohur e bën shumë më të lehtë raportimin e një çështjeje.
- Sigurohuni që trajnerët dhe administratorët të dinë kush jeni dhe çfarë përfshin roli juaj si Oficer i Mbrojtjes. Kontrolloni me ta nëse mund të përfshijnë gjithashtu të dhënat tuaja të kontaktit në prezantimet e tyre, broshura ose materiale të tjera për sportistët, prindërit, etj.
- Nëse klubi juaj ka një faqe specifike për raportimin në faqen e internetit, sigurohuni që të jetë sa më personale (shih tekstin shembullor më sipër). Shtoni një fotografi tek të dhënat tuaja të kontaktit dhe sigurohuni që të mund të kontaktoheni në mënyra të ndryshme (telefon, email, formular kontakti, WhatsApp, etj.). Çdokush pëlqen të lidhet në mënyrën e vet (me shkrim, me telefonatë, etj.).
- Sigurohuni që të mund të kontaktoheni me telefon, në çdo rast. Shpesh, njerëzit nuk kanë dëshirë të shkruajnë të gjithë rastin në një email ose formular. Dhe mos harroni, kjo është shpesh një çështje që sjell shqetësim.
- Mendoni për një mesazh automatik në sekretarinë telefonike që të frymëzojë besim dhe të shpjegojë qartë kur do t'i telefononi përsëri (p.sh. nëse jeni i/e disponueshëm/e vetëm gjatë orareve të caktuara).
- Bëni që adresa juaj e emailit të jetë sa më personale, p.sh. SO_Martin@sportsclub.com. Nëse preferoni të punoni me një adresë të përgjithshme, si p.sh. report@sportsclub.com, atëherë sigurohuni që të komunikoni qartë se jeni i vetmi/ja që lexon emailin e raportuesit.
- Përsëritje: një postim në rrjete sociale ose një email nuk mjafton që të njiheni nga të gjithë në klub. Komunikoni rregullisht gjatë gjithë vitit për rolin tuaj si Oficer i Mbrojtjes dhe përdorni kanale të ndryshme.